

VENDIM
Nr. 154, datë 27.2.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 633, DATË 26.10.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MASAT KUNDËR NDOTJES SË AJRIT NGA SHKARKIMET E
MJETEVE MOTORIKE DHE REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR TË
NDOTËSVE TË GAZTË DHE TË LËNDËS SË NGURTË PEZULL NGA MOTORËT ME
NDEZJE POZITIVE DHE ATA ME NDEZJE ME KOMPRESION QË DJEGIN GAZ
NATYROR APO TË LËNGSHËM PËR PËRDORIM NË AUTOMJETE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 13, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “c”, e pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Autoveturat e përdorura, të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 4.”.

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Automjetet e blera para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që janë nisur për t’u çliruar për qarkullim të lirë dhe regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë hyrë në territorin shqiptar brenda datës 31.12.2018 dhe nuk kanë përfunduar procedurat doganore dhe të regjistrimit, kanë afat deri në 31 dhjetor 2019, për kryerjen e procedurave të nevojshme.”.

c) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Ngarkohen autoritetet doganore të kontrollojnë dokumentacionin shoqërues të mjetit motorik dhe të ndalojnë importin e mjeteve motorike që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 4 dhe 8, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, autoritetet doganore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama